



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

PROGRAMI KOMBËTAR I VAKSINIMIT

PROCESI I VAKSINIMIT NDAJ COVID-19 DHE GRIPIT SEZONAL

JAVA 6, 2026

Permbajtja:

- 1. VAKSINIMI NDAJ GRIPIT SEZONAL 2025-2026 (java 6, 2026)**
- 2. VAKSINIMI NDAJ COVID-19 (Java 43, 2024-java 6, 2026)**

1. VAKSINIMI NDAJ GRIPIT SEZONAL 2025-2026

Vaksinimi ndaj gripit sezonal është një masë parandaluese e rëndësishme për reduktimin e shtrimeve në spitale, komplikacioneve dhe vdekjeve të shkaktuara nga viruset respiratorë, veçanërisht tek personat me sëmundje bashkëshoqëruese.

Në Shqipëri, në vitin 2007 u hartuan politikat e para për vaksinimin ndaj gripit sezonal për grupet e riskut, të cilat përfshinin personat me sëmundje kronike dhe personelin shëndetësor. Në vijim, në vitin 2009, u bënë ndryshime në politikat e vaksinimit ndaj gripit sezonal për grupet e riskut, duke përfshirë:

- Të moshuarit
- Personat me sëmundje kronike
- Personelin shëndetësor
- Gratë shtatzëna

Në vitin 2014 u bënë ndryshime të tjera në politikat e vaksinimit ndaj gripit për grupet e riskut, ku krahas të moshuarve, personave me sëmundje kronike dhe grave shtatzëna, u shtuan edhe fëmijët dhe personat obezë, si dhe u specifikua personeli shëndetësor target.

Në vitin 2016 u kryen modifikime të tjera në politikat e vaksinimit ndaj gripit, me rekomandimin për vaksinimin e të gjithë personave nga mosha 6 muaj e lart, duke u fokusuar veçanërisht tek grupet e riskut: fëmijët, gratë shtatzëna, të moshuarit, personat me sëmundje kronike, personat obezë dhe personeli shëndetësor target.

Në vitin 2017 dhe në vijim, në rekomandimet e vaksinimit u shtuan edhe personat me diabet, si dhe u përfshi i gjithë personeli shëndetësor. Një program i posaçëm vaksinimi për punonjësit e kujdesit shëndetësor ishte krijuar që në vitin 2014.


Që nga viti 2018, vaksina e gripit është përfshirë në planin dhe parashikimin kombëtar të imunizimit. Buxheti për vaksinën e gripit është përfshirë në linjën buxhetore të vaksinave të fëmijëve, në kuadër të Programit Kombëtar të Vaksinimit.

Tashmë, vaksinimi ndaj gripit sezonal kryhet prej shumë vitesh dhe vazhdon të rekomandohet për personat në risk, të cilët përfshijnë:

- Punonjësit shëndetësorë (mjekë, infermierë, staf mbështetës)

- Persona me sëmundje kardiovaskulare, diabet, sëmundje pulmonare dhe sëmundje të tjera kronike të mëlçisë ose veshkave, si dhe persona me tumor/kancer
- Persona obezë
- Persona me imunitet të komprometuar
- Gra shtatzëna
- Persona mbi 65 vjeç
- Mësues dhe edukatorë
- Policë dhe forcat e rendit
- Fëmijë nga 6 muaj deri në 12 vjeç

Sasia e dozave të prokuruar ndë vite ka ardhur në rritje. Në grafik paraqiten dozat e blera nga Qeveria Shqiptare, donacionet, si dhe vaksinat e blera nga firmat farmaceutike ndë vite.



Grafiku 1: Sasia e vaksinave te gripit te ardhura ndë vite

- Gjatë sezonit të gripit **2025-2026** Programi Kombëtar i Vaksinit, pranë Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) ka shpërndare në 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) **280,000 doza të vaksinës ndaj gripit sezonal**, përkatësisht: 40,000 doza në flakon një-dozësh dhe 240,000 doza në flakon me 10 doza. Vaksinimi ndaj gripit sezonal për sezonin **2025–2026** nisi më **22 shtator 2025** në të gjithë vendin.
- Gjatë sezonit **2024-2025**, kanë ardhur **280 000** doza vaksine gripi, 4 valente (40 000 doza në flakon me një dozë dhe 240 000 doza në flakon me 10 doza) dhe fushata e vaksinit ndaj gripit sezonal 2024-2025 filloi në datën **7 Tetor 2024** në të gjithë vendin.
- Gjatë sezonit **2023-2024** kanë ardhur **260 000 doza** vaksine gripi, 4 valente dhe fushata e vaksinit kundër gripit sezonal 2023-2024 filloi në datën **16 Tetor 2023** në të gjithë vendin.

Llojet e vaksinave të përdorura


- Gjatë këtyre sezoneve, në Shqipëri janë aplikuar **vaksinat 4-valente** me virion te copëzuar, te inaktivizuara, GC FLU të prodhuara nga GC Biopharma në Korenë e Jugut dhe të parakualifikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) **të cilat janë në flakone** prej 0.5ml dhe aplikohen në mënyre intramuskulare.

Ecuria e vaksinit:

Aplikimi dhe regjistrimi në SIV i vaksinave ndaj gripit sezonal ka filluar gjatë sezonit 2023-2024. Burimi i të dhënave është sistemi SIV për të tre sezonet.

- Për sezonin 2025-2026 deri në javën 6/2026 (22 Shtator – 8 shkurt) janë kryer gjithsej 241 461 doza, që përbëjnë 86.2 % të dozave të shpërndara.
- Për sezonin 2024-2025 deri në javën 6/2025 (7 tetor – 9 shkurt) ishin kryer gjithsej 221 406 që përbënin 79 % të dozave të shpërndara.
- Për sezonin 2023-2024 deri në javën 6/2024 (16 tetor – 11 shkurt) ishin kryer gjithsej 212 725 që përbënin 81.8 % të dozave të shpërndara.

Ecuria e vaksinit deri në javën e 6-të për 3 sezonet e gripit të sipërpërmendura paraqiten në grafikun mëposhtë. Dhe në grafik tregohet që në 3 sezonet e gripit sezonal javët e para kanë dhe numrin më të lartë të aplikimit të vaksinave dhe më pas ka një rënie graduale.



Grafiku 2: Ecuria e vaksinimit sipas javëve për 3 sezone të gripit sezonal


Shpërndarja e dozave dhe të aplikuara sipas NJVKSH-ve për sezonin 2025-2026 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	NJVKSH	Sasia ne doza	Sasia e shperndare (GC Flu 1/doze)	Sasia e aplikuar me (GC Flu 1/doze)	% e aplikimit (GC Flu 1/doze)	Sasia e shperndare (GC Flu 10/doze)	Sasia e aplikuar me (GC Flu 10/doze)	% e aplikimit (GC Flu 10/doze)	TOTAL	% e aplikimit ne total
Shkodër	Shkodër	14000	1000	796	79.6	13000	10148	78.06	10944	78.17
	Malësi e Madhe	3500	500	397	79.4	3000	2999	99.97	3396	97.03
	Pukë	2500	500	315	63.0	2000	1934	96.70	2249	89.96
Kukës	Kukës	4000	500	487	97.4	3500	3408	97.37	3895	97.38
	Has	1500	500	498	99.6	1000	1000	100.00	1498	99.87
	Tropojë	2000	500	487	97.4	1500	1431	95.40	1918	95.90
Lezhë	Lezhë	6000	500	480	96.0	5500	5500	100.00	5980	99.67
	Mirditë	2500	500	497	99.4	2000	2000	100.00	2497	99.88
	Kurbin	4500	500	500	100.0	4000	3418	85.45	3918	87.07
Tiranë	Tiranë	36000	6000	4867	81.1	30000	26081	86.94	30948	85.97
	Kavaje	7000	1000	760	76.0	6000	4847	80.78	5607	80.10
Durrës	Durrës	17000	3000	2169	72.3	14000	11698	83.56	13867	81.57
	Krujë	6000	1000	587	58.7	5000	4344	86.88	4931	82.18
Dibër	Dibër	6000	1000	909	90.9	5000	4851	97.02	5760	96.00
	Bulqizë	3500	500	394	78.8	3000	2043	68.10	2437	69.63
	Mat	3800	800	585	73.1	3000	2351	78.37	2936	77.26
Fier	Fier	27600	2600	2559	98.4	25000	25000	100.00	27559	99.85
	Mallakastër	2900	400	400	100.0	2500	2417	96.68	2817	97.14
	Lushnjë	22000	2000	1723	86.2	20000	13884	69.42	15607	70.94
Vlorë	Vlorë	18500	1500	1455	97.0	17000	14293	84.08	15748	85.12
	Delvinë	3450	450	413	91.8	3000	1505	50.17	1918	55.59
	Sarandë	4800	800	682	85.3	4000	3632	90.80	4314	89.88
Gjirokastrë	Gjirokastrë	7500	1000	789	78.9	6500	5541	85.25	6330	84.40
	Përmet	3450	450	302	67.1	3000	2725	90.83	3027	87.74
	Tepelenë	3000	500	461	92.2	2500	2116	84.64	2577	85.90
Korçë	Korçë	11000	1000	978	97.8	10000	9876	98.76	10854	98.67
	Pogradec	6330	830	740	89.2	5500	5313	96.60	6053	95.62
	Devoll	2500	500	462	92.4	2000	1934	96.70	2396	95.84
	Kolonjë	1500	500	467	93.4	1000	942	94.20	1409	93.93
Berat	Berat	11000	1000	867	86.7	10000	9674	96.74	10541	95.83
	Kuçove	3500	500	496	99.2	3000	2911	97.03	3407	97.34
	Skrapar	3500	500	500	100.0	3000	3000	100.00	3500	100.00
Elbasan	Elbasan	16000	4000	3627	90.7	12000	7360	61.33	10987	68.67
	Peqin	3000	500	356	71.2	2500	2150	86.00	2506	83.53
	Gramsh	3500	500	494	98.8	3000	3000	100.00	3494	99.83
	Librazhd	3500	500	314	62.8	3000	2244	74.80	2558	73.09
Total		278330	38330	32813		240000	207570		240383	86.37

Tabela 1: Sasia e dozave te shpërndara dhe përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, java 6/2026


Ecuria e procesit te vaksinimit sipas katër rajoneve të vendit

DROSHKSH Tiranë: përfshin NJVKSH Bulqizë, Dibër, Mat, Durrës, Krujë, Tiranë dhe Kavajë. NJVKSH-të me përdorimin më të lartë dhe konstant për 3 sezonet janë NJVKSH Dibër me mbi 90 % dhe NJVKSH Durrës mbi 80 %. Njvksh Krujë ka një rritje të përdorimit nga sezoni 2024-2025 (49.4%) në (82.5 %) dhe gjithashtu NJVKSH Tiranë ka një përdorim më të mirë (85.9 %) gjatë sezonit 2025-2026. Përdorimi i vaksinës në përqindje për këtë rajon paraqitet në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku 3: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Tiranë


DROSHKSH Shkodër: përfshin NJVKSH Has, Kukës, Tropojë, Lezhë, Kurbin, Mirditë, Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe. Ky rajon në sezonin 2025-2026 ka patur një rritje të dukshme të aplikimit të vaksinës kryesisht në NJVKSH Has (99.9 %), NJVKSH Mirditë (99.9%), NJVKSH Lezhë (99.6 %), NJVKSH M.Madhe (97 %), NJVKSH Pukë (90 %), NJVKSH Kurbin (87%), NJVKSH Shkodër (78.1 %).



Grafiku 4: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Shkodër


DROSHKSH Elbasan: përfshin NJVKSH Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Berat, Kuçovë, Skrapar, Elbasan, Peqin, Gramsh dhe Librazhd. Ky rajon ka patur në përgjithësi një ecuri të mirë vaksinimi por ato që në sezonin e fundit kanë përqindje më të lartë janë Njvksh Skrapar që ka arritur 100 % të përdorimit, NJVKSH Gramsh (99.8 %), Njvksh Korçë (98.6 %), NJVKSH Kuçovë (97.3 %), NJVKSH Devoll (95.8 %), Njvksh Pogradec (95.6 %),

NJVKSH Kolonjë (93.9 %). Njvksh Elbasan ka patur një ecuri të ngadaltë me përqindjen më të ulët (68.6 %) dhe NJVKSH Librazhd (73.1 %) për sezonin 2025-2026.



Grafiku 5: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Elbasan


DROSHKSH Vlorë: përfshin NJVKSH Fier, Lushnjë, Mallakastër, Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë, Delvinë, Sarandë dhe Vlorë. Njvksh Fier në 3 sezone ka patur një përqindje të lartë vaksinimi me mbi (95 %). Disa Njvksh kanë një rritje të lartë të përdorimit si NJVKSH Mallakastër (97.1%), NJVKSH Përmet (87.7 %), Njvksh Tepelenë (85.9 %). Njvksh Gjirokastrë ka patur një ulje nga 100 % në sezonin 2023-2024 në (84.4 %) për sezonin 2025-2026. Njvksh Delvinë ka përqindjen më të ulët të përdorimit në 3 sezone (55.3 %).



Grafiku 6: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Vlorë

Mbulesa vaksinale sipas grup-moshave


Grafiku mëposhtëm paraqet mbulesën vaksinale sipas grupmoshave për tre sezonet e gripit. Grupmosha me mbulesën më të lartë vaksinale në te tre sezonet është grup mosha mbi 80 vjeç përkatësisht në sezonin 2025-2026 (31.5 %), për sezonin 2024-2025 (28%) dhe në sezonin 2023-2024 (24.8 %).



Grafiku 7: Mbulesa vaksinale sipas grup-moshave për 3 sezone të gripit sezonal

Mbulesa vaksinale sipas grupeve të riskut


Grafiku paraqet mbulesën vaksinale sipas grupeve të riskut dhe mbulesa vaksinale në 2 sezonet e gripit sezonal është më e lartë është tek personat me sëmundje kardiovaskulare mbi (35 %) dhe për sezonin 2025-2026 është (39.4 %). Të dhënat e popullatës me sëmundje kronike janë marrë nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH).



Grafiku 8: Mbulesa vaksinale sipas grupeve të riskut, tre sezone të gripit sezonal


Mbulesa vaksinale tek personeli shëndetësor

Stafi mjekësor është ndër grupet më të ekspozuara ndaj gripit sezonal për shkak të kontaktit të vazhdueshëm me pacientët dhe ekspozimit të lartë ndaj infeksioneve respiratore. Në dy sezonet e mëparshme mbulesa vaksinale ka qënë më e ulët tek personeli shëndetësor ndersa në sezonin aktual 2025-2026 mbulesa vaksinale është 52.5 %.

*Grafiku 9: Mbulesa vaksinale sipas personelit shëndetësor*

Përdorimi i vaksinës sipas profesioneve

Gjatë tre sezoneve të gripit sezonal mësuesit janë ato me përdorimin më të mirë të vaksinës ndaj gripit sezonal. Përqindjen më të ulët të përdorimit e kanë edukatorët.



Grafiku 10: Aplikimi i vaksinës sipas profesioneve, tre sezonet e gripit sezonal

2. VAKSINIMI NDAJ COVID-19 (Java 43, 2024-java 6, 2026)

Në mbledhjen e datës 22 gusht 2024, Komiteti Shqiptar i Ekspertëve të Vaksinimit (NITAG) rekomandoi:

1. Vaksinimi ndaj COVID-19 duhet të vazhdojë.
2. Çdo vit duhet të aplikohet vakcina ndaj COVID-19 për grupet më prioritare dhe në rrezik.
3. Vakcina COVID-19 duhet të administrohet në të njëjtën kohë me vaksinën kundër gripit sezonal, kur është e mundur, për të shmangur që qytetarët të paraqiten dy herë në qendrat shëndetësore.
4. Të vaksinohen me një dozë të vaksinës monovalente, pavarësisht nga statusi i mëparshëm i vaksinimit, personat në grupet e mëposhtme:
 - Punonjësit shëndetësorë dhe ata që punojnë në institucione të kujdesit afatgjatë.
 - Personat që jetojnë në institucione të kujdesit afatgjatë (mbi 12 vjeç).
 - Të gjithë personat mbi 60 vjeç.
 - Personat mbi 12 vjeç me sëmundje bashkëshoqëruese, përfshirë:
 - Sëmundje kardiovaskulare.
 - Diabet.

- Sëmundje obstruktive të mushkërive.
 - Sëmundje kronike të veshkave dhe mëlçisë.
 - Lloje të ndryshme kanceri.
 - Gjendje që shkaktojnë frenim të imunitetit.
 - Obezitet.
- Gratë shtatzëna.

Vaksina COMIRNATY™ e Disponueshme në Shqipëri:

Aktualisht në Shqipëri është e disponueshme vakcina **COMIRNATY™ Monovalent [Omicron JN.1]**

COMIRNATY™ Monovalent [Omicron JN.1]


- **Përmbajtje aktive:** *bretovameran* (mRNA për nënvariantin Omicron JN.1)
- **Përdorimi:** 30 mikrogramë për adoleshentë dhe të rritur ≥ 12 vjeç
- **Data e skadencës së dozave të ardhura:** 31 mars 2026
- **Sasia e ardhur më 17 prill 2025:** 5,760 doza

Dokumentimi i Vaksinimit

Çdo vaksinë e administruar regjistrohet **në kohë reale në Sistemin e Informimit të Vaksinimit (SIV)** dhe është e disponueshme për qytetarët në **portalin e-Albania**, te seksioni “**Kartela ime e Vaksinimit**”.

Kartela ofrohet në **shqip dhe anglisht** dhe është e vlefshme për përdorim personal apo zyrtar.


Nga fillimi i përdorimit në javën e 43-të të vitit 2024 deri në javën e 6-të të vitit 2026, në Shqipëri janë administruar gjithsej **1,701 doza**.



Municipality	Number of Applications
Tirane	510
Fier	190
Vlore	125
Korce	105
Shkoder	90
Lushnje	75
Elbasan	75
Malesi e Madhe	65
Pogradec	55
Durres	40
Kucove	35
Diber	30
Librazhd	30
Lezhe	30
Gjirokaster	25
Devoll	25
Mallakaster	15
Permet	15
Sarande	15
Mirdite	15
Kukes	15
Kruje	15
Kolonje	10
Kurbin	10
Tropoje	10
Kavaje	10
Tepelene	10
Berat	5
Puke	5

Grafiku 2. Numri i vaksinave ndaj COVID-19 te aplikuara sipas NJVKSH-ve (java 43, 2024-java 6, 2026)


Stafi mjekësor përbën një nga grupet me risk të lartë për ekspozim ndaj infeksionit me COVID-19, për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë me pacientët dhe mjediset shëndetësore. Vaksinimi i këtij grupi është thelbësor jo vetëm për mbrojtjen e shëndetit të tyre personal, por edhe për të garantuar sigurinë e pacientëve dhe vazhdimësinë e shërbimeve shëndetësore. Megjithatë, të dhënat tregojnë se përdorimi i vaksinës në këtë kategori mbetet i ulët. Ne total janë aplikuar **116 doza** deri javën e 6, 2026.



Grafiku 3: Numri i stafit mjeksor te vaksinuar ndaj COVID-19, (java 43, 2024-java 6 2026)

Infermierët kanë numrin më të madh të vaksinimeve (77), ndjekur nga **mjekët** me (30). **Stafi mbështetës** ka marrë **9 doza**. **Totali i përgjithshëm është 115**, duke reflektuar numrin e përgjithshëm të vaksinimeve në këtë kategori profesionale.


Grupet në rrezik për komplikacione të rënda nga COVID-19 përfshijnë të moshuarit, personat me sëmundje kronike (si diabet, hipertension, sëmundje kardiovaskulare, respiratore, renale dhe hepatike), individët me imunitet të kompromentuar, gratë shtatzëna, si dhe punonjësit shëndetësorë. Vaksinimi i këtyre grupeve është një masë thelbësore parandaluese për të reduktuar shtrimet në spitale, format e rënda të sëmundjes dhe rrezikun e vdekshmërisë. Për më tepër, mbrojtja e këtyre kategorive ka ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtjen e kapaciteteve të sistemit shëndetësor dhe në sigurimin e funksionimit normal të shërbimeve të tjera mjekësore. Rekomandimet ndërkombëtare dhe ato kombëtare theksojnë rëndësinë e vaksinimit periodik për këto grupe, duke pasur parasysh se imuniteti i fituar nga vaksina apo infeksioni i mëparshëm zbehet me kalimin e kohës.



Grafiku 4: Numri i personave te vaksinuar ndaj COVID-19 sipas grupeve te riskut, (java 43, 2024-java 6, 2026)

Vaksinimi ndaj COVID-19 sipas grupmoshave

Vaksinimi kundër COVID-19 mbetet një ndër masat kryesore për parandalimin e formave të rënda të sëmundjes dhe uljen e numrit të shtrimeve në spitale. Efektiviteti dhe rëndësia e vaksinimit ndryshon sipas grupmoshave, duke reflektuar nivelin e rrezikut që secila kategori paraqet. Grupmosha **25–39 vjeç** ka numrin më të lartë të vaksinimeve (472). Pas saj renditen grupmoshat **50–59 vjeç (326)** dhe **60–69 vjeç (313)**. Grupmoshat më të reja (12–17 vjeç) dhe më të moshuarit mbi 80 vjeç kanë numrat më të ulët të vaksinimit.



Grafiku 5: Numri i vaksinave ndaj COVID-19 te aplikuara sipas grup-moshave, (java 43, 2024-java 6, 2026)

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK